

VENDIM
Nr. 650, datë 14.9.2016

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, INTENSITETIT DHE TË PROCEDURËS PËR
DHËNIEN DHE AUTORIZIMIN E NDIHMËS SHTETËRORE NË FORMËN E
KOMPENSIMIT TË SHËRBIMEVE ME INTERES TË PËRGJITHSHËM EKONOMIK
DHE PUBLIK¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 13/3, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipër-marrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton kriteret, intensitetin e ndihmës dhe procedurat për dhënie e autorizimin e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik.

2. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose përdorur në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.

3. Përveç sa parashikohet në pikën 2, të këtij kreu, për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Shërbim i interesit të përgjithshëm publik dhe ekonomik”, çdo shërbim në interesin e përgjithshëm, të cilin ndërmarrja përfituese ngarkohet ose detyrohet ta ofrojë, në bazë të një mandati të shërbimit publik (në vijim shërbim publik).

b) “Mandat i shërbimit publik”, akti juridik, në formë ligji, vendimi, koncesioni apo kontrate, private ose publike, partneriteti publik privat, në bazë të të cilit ndërmarrja ngarkohet ose detyrohet të ofrojë një shërbim publik dhe që përmban të dhënat e përcaktuara në kreun II, të këtij vendimi.

c) “Marzh fitimi i arsyeshëm”, norma e kthimit të kapitalit për nivelin e rrezikut që ka ndërmarrja për aktivitetin që kryen, e llogaritur për të gjithë periudhën e mandatit, pavarësisht nëse ofron ose jo shërbime publike.

ç) “Rrezik”, çdo faktor që mund të shkaktojë uljen e të ardhurave të pritshme ose rritjen e kostove të pritshme, faktorë, këta, që varen nga sektori ekonomik ose shërbimi publik dhe që nuk janë marrë parasysh në parametrat e llogaritjes së kompensimit.

d) “Kompensim”, çdo lloj ndihme, në kuptimin e ligjit për ndihmën shtetërore, që i jepet një ndërmarrjeje në formë kompensimi për shërbimet publike të ofruara.

dh) “Kosto neto”, diferenca ndërmjet kostonë së shërbimeve publike dhe të ardhurave të pritshme ose të realizuara.

e) “Të ardhura”, të ardhurat dhe përfitimet e çdo natyre, të përfituara në kuadrin e ofrimit të shërbimit dhe të përfituara nga aktivitete të tjera, që nuk përbëjnë shërbime publike, kur ndërmarrja ka të drejta ekskluzive ose të veçanta apo kur mandati i shërbimit publik vendos që të ardhurat e fituara në kuadrin e aktiviteteve që nuk përbëjnë shërbime publike të përdoren për financimin e shërbimeve publike.

ë) “Aktivitet tjetër, që nuk përbën shërbim publik”, çdo aktivitet, të cilin ndërmarrja përfituese nuk është e ngarkuar ose e detyruar ta ofrojë në bazë të një mandati të shërbimit publik.

II. KUSHTET DHE KRITERET PËR DHËNIEN E LEJIMIN E NDIHMËS SHTE-

¹ Ky vendim është përafëruar pjesërisht me vendimin e Komisionit Evropian “Për zbatimin e nenit 106(2) TFBE për ndihmën shtetërore në formë kompensimi për shërbime të interesit të përgjithshëm ekonomik”, Celex 32012D0021, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian OJ L 7, 11.1.2012, L 7, f. 3.

TËRORRE NË FORMËN E KOMPENSIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE

1. Në çdo rast, ndihma shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike jepet dhe lejohet vetëm nëse ndërmarrja ka një mandat për ofrimin e shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik dhe publik, i cili përmbush kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij kreu.

2. Mandati i shërbimit publik duhet të përmbajë, në veçanti,:

a) përmbajtjen dhe përcaktimin sa më të detajuar të detyrimeve të shërbimit publik dhe, kur është e mundur, listën e shërbimeve publike që ndërmarrja përfituese duhet të kryejë;

b) ndërmarrjen përfituese dhe territorin në të cilin duhet të ofrohet shërbimi publik;

c) kohëzgjatjen e detyrimeve të shërbimit publik. Në parim, mandati nuk e kalon një periudhë dhjetëvjeçare, përveç rasteve kur ofruesi i shërbimit detyrohet ose angazhohet të kryejë një investim të rëndësishëm, të përdorshëm, i cili ka nevojë të amortizohet për një kohë më të gjatë, në përputhje me parimet kontabël përgjithësisht të pranuar;

ç) mekanizmin e kompensimit dhe të para-metrave për llogaritjen, monitorimin dhe rishikimin e kompensimit. Parametrat për llogaritjen e kompensimit duhet të jenë objektivë dhe të mat-shëm;

d) masat për shmangien dhe kthimin e çdo mbikompensimi;

dh) çdo të drejtë ekskluzive apo të veçantë që i është caktuar ndërmarrjes, të cilat duhet të parashikohen paraprakisht me ligj.

3. Dhënia e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit për shërbime publike duhet të jetë proporcionale.

4. Shuma e kompensimit për shërbime publike nuk duhet të kalojë koston neto të ofrimit të shërbimit publik, përfshirë dhe një marzh fitimi të arsyeshëm. Llogaritja e koston neto, marzhit të fitimit dhe kontrolli i mbikompensimit kryhet sipas parashikimeve të bëra në kreun III, të këtij vendimi.

5. Ndalohet financimi i aktiviteteve të tjera, që nuk përbëjnë shërbime publike, me anë të shumës së marrë për të kompensuar shërbimet publike.

6. Çdo ndërmarrje përfituese, që kryen shërbime publike dhe aktivitete të tjera, të cilat nuk përbëjnë shërbime publike, është e detyruar të pasqyrojë në kontabilitetin e ndërmarrjes, të ndara, kostot dhe të ardhurat e shërbimeve publike nga kostot e të ardhurat e aktiviteteve të tjera, që nuk përbëjnë shërbime publike. Kontabiliteti pasqyron, gjitha-shtu, edhe metodën e përdorur për ndarjen e kostove dhe të ardhurave.

7. Shërbimet publike mund të financohen me të ardhura të vjela nga aktivitete të tjera, që nuk përbëjnë shërbime publike.

8. Ndihma në formë kompensimi për shërbimet publike është e lejueshme për periudhën e kohëzgjatjes së mandatit të shërbimit, në rastet kur:

a) kompensimi për shërbimet publike nuk e kalon shumën vjetore prej 2 085 000 000 (dy miliardë e tetëdhjetë e pesë milionë) lekësh. Në rastin kur mandati jepet për një periudhë më të gjatë se një vit, shuma vjetore llogaritet si mesatare e shumës vjetore të kompensimit gjatë periudhës së mandatit;

b) kompensimi jepet për ofrimin e shërbimeve publike nga spitalet që ofrojnë shërbime mjekësore, përfshirë shërbimet e urgjencës;

c) kompensimi jepet për ofrimin e shërbimeve publike, me qëllim përmbushjen e nevojave sociale, të shëndetit, përkujdesjes ndaj fëmijëve, integritit social, integritit në tregun e punës apo banesave sociale;

ç) kompensimi jepet për ofrimin e shërbimeve publike, nga linjat ajrore ose detare të brendshme, në rastin kur trafiku mesatar vjetor, në dy vitet e mëparshme financiare, nuk i ka kaluar 300 000 (treqind mijë) pasagjerë;

d) kompensimi jepet për ofrimin e shërbimeve publike për aeroportet, në rastin kur trafiku mesatar vjetor, gjatë dy viteve financiare të mëparshme, nuk i ka kaluar 200 000 (dyqind mijë) pasagjerë, si dhe për portet, për të cilat trafiku mesatar vjetor, gjatë dy viteve financiare të mëparshme, nuk i ka kaluar 300 000 (treqind mijë) pasagjerë.

9. Ndihamat në formën e kompensimit të shërbimeve publike, që nuk përfshihen në rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij kreu, mund të autorizohen nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pas vlerësimit, në bazë të kriterëve të përgjithshme, të përcaktuara në këtë vendim dhe në ligjin për ndihmën shtetërore.

III. LLOGARITJA E KOMPENSIMIT

1. Dhënia e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit për shërbime publike nuk duhet të kalojë koston neto të ofrimit të shërbimit publik, përfshirë edhe një marzh fitimi të arsyeshëm.

2. Kostoja neto llogaritet si diferenca ndërmjet koston së përcaktuar në pikën 3 dhe të ardhurave të përcaktuara në pikën 4, të këtij kreu ose si diferenca ndërmjet koston neto të ndërmarrjes, përfshirë shërbimet publike dhe koston së po kësaj ndërmarrjeje, pa përfshirë shërbimet publike (kosto e evitueshme).

3. Kostot që lidhen me shërbimin publik janë kosto direkte të ofrimit të shërbimit publik dhe një pjesë e përpjesëtueshme e kostove të përbashkëta të ofrimit të shërbimit publik e të një aktiviteti tjetër, që nuk përbën shërbim publik. Llogaritja e koston bëhet, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur ndërmarrja ofron vetëm shërbime publike, për të cilat kompensohet, për llogaritjen e koston neto merren parasysh të gjitha kostot e ofrimit të shërbimit publik;

b) Në rastin kur ndërmarrja, përveç shërbi-meve publike ushtron edhe një aktivitet tjetër, që nuk përbën shërbim publik, merren parasysh, për efekt llogaritjeje të koston neto, vetëm kostot që lidhen me ofrimin e shërbimit publik.

4. Të ardhurat e ndërmarrjes janë të gjitha të ardhurat e vjela gjatë ofrimit të shërbimit publik. Në rastin kur ndërmarrja gëzon të drejta speciale, ekskluzive apo avantazhe të tjera nga shteti, për aktivitete të tjera, që nuk përbëjnë shërbim publik, të gjitha të ardhurat e vjela në ofrimin e këtyre aktiviteteve merren parasysh (përfshihen) për llogaritjen e koston neto, pas zbritjes së një marzhi fitimi të arsyeshëm, i cili i mbetet ndërmarrjes. Në mandatin e shërbimit publik mund të përcaktohet që të gjitha ose një pjesë e të ardhurave që vilen nga një aktivitet tjetër i ndërmarrjes, i cili nuk përbën shërbim publik, të përdoren plotësisht apo pjesërisht për llogari të financimit të shërbimit me interes të përgjithshëm ekonomik.

5. Për përcaktimin e marzhit të fitimit të arsyeshëm zbatohen këto rregulla:

a) Në rastin kur e gjithë kostoja neto e shërbimeve publike kompensohet *ex post*, norma e kthimit të kapitalit, që përcakton marzhin e fitimit të arsyeshëm, nuk e kalon normën e bonos së thesarit me maturitet periudhën e mandatit, të shprehur në lekë, dhe 100 pikë bazë shtesë;

b) Në rastin kur ofrimi i shërbimit publik paraqet një rrezik financiar, i cili nuk merret parasysh në parametrat e llogaritjes së kompensimit të përcaktuar paraprakisht (*ex ante*), norma e kthimit të kapitalit, që përcakton marzhin e fitimit të arsyeshëm, përbëhet nga norma e bonos së thesarit me maturitet periudhën e mandatit, të shprehur në lekë, dhe 100 pikë bazë shtesë. Kur rreziku financiar lidhur me aktivitetin e shërbimit publik konsiderohet si i madh, në vend të normës së bonos së thesarit merret parasysh norma e obligacioneve të emetuara nga Banka e Shqipërisë, me maturitet periudhën e mandatit, të shprehur në lekë dhe 100 pikë bazë shtesë.

6. Dhënësi i ndihmës duhet të garantojë që shuma e kompensimit për ofrimin e shërbimit publik të mos tejkalojë shumën e llogaritur sipas pikës 1, të këtij kreu.

7. Shuma e dhënë për shërbime publike, e cila nuk kalon 10% të kompensimit mesatar të lejueshëm, në përputhje me këtë vendim, mund të mbartet në periudhën e ardhshme të mandatit, me kusht që të zbritet nga kompensimi i periudhës së ardhshme.

8. Çdo shumë e dhënë, që kalon kompensimin e llogaritur sipas këtij vendimi, duhet t'i kthehet dhënësit.

9. Dhënësi i mandatit të shërbimit publik ose i kompensimit për shërbimin publik kontrollon rregullisht nëse kompensimi i dhënë llogaritet dhe përdoret në përputhje me këtë vendim. Ky kontroll kryhet, të paktën, çdo tre vjet.

IV. PROCEDURA PËR AUTORIZIMIN DHE MONITORIMIN E NDIHMËS NË FORMËN E KOMPENSIMIT TË SHËRBI-MEVE PUBLIKE

1. Çdo plan për dhënien e ndihmës shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike njoftohet pranë strukturës përgjegjëse për ndihmën shtetërore, në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore, e cila kontrollon nëse përmbu-shen kushtet e parashikuara në këtë vendim, dhe ia përcjell njoftimin, për shqyrtim, Komisionit të Ndihmës Shtetërore.

2. Ndihma njoftohet nga dhënësi para dhënies dhe, në njoftimin e saj, dhënësi jep një vlerësim të rrezikut financiar lidhur me aktivitetin e shërbimit publik. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vendos vlerën e normës së kthimit të kapitalit që shërben si marzh fitimi të arsyeshëm, në rastin konkret, duke marrë parasysh vlerësimin e dhënësit dhe vlerën e normës së kthimit të kapitalit për aktivitete të ngjashme.

3. Komisioni merr vendim, në të cilin konstatohet që ndihma e dhënë përmbush kushtet e përcaktuara në pikën 8, të kreu II, të këtij vendimi, dhe, si rrjedhim, autorizon dhënien e ndihmës.

4. Komisioni merr vendim për pezullimin e ndihmës nëse konstaton se një ose më shumë kushte nuk përmbushen ose kur ka dyshime serioze për pajtueshmërinë e ndihmës me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

5. Struktura përgjegjëse për kontrollin e ndihmës shtetërore mban një regjistër të ndihmave në formën e kompensimit të shërbimit publik, në përputhje me detyrën e përcaktuar në ligjin për ndihmën shtetërore.

6. Me kërkesë të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, dhënësi e përfituesi japin çdo informacion për natyrën, qëllimin, shumën dhe llogaritjen e grantit ose ekuivalentit bruto të grantit, për çdo lloj ndihme tjetër të marrë nga ndërmarrja përfituese dhe për çdo informacion të kërkuar në lidhje me ndihmat e marra ose të planifikuara për t'u marrë.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohet ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi